

Specifikimet teknike

Blerje ushqime ,viti 2025 – 2026.

Të gjitha ushqimet të jenë brenda parametave dhe standarteve të miratuara nga organet kompetente,të jenë të freskëta.

Patate

Kërkohet cilesia e mirë, te jete e plote, te forta, te pastra e te thata, jo jeshile, jo te mbira me ngjyre dhe me sytha tipike te kultivarit. Kokrra te jete e pjekur. Madhesia e kokrres te jete per pataten dimerore mbi 5 cm dhe per ato verore mbi 4 cm. Nuk lejohen te gjelbera, te vyshkura, te mbira, te çara e te prera, te kalbura, zgjebe ne plage, njolla boje hiri e ndryshku, demtime nga krimbi, demtime nga dosa dhe te papastruara nga dherat. Duhet te jene te ambalazhuara ne thase rrjete.

Fasule

Kërkohet cilesia e mirë,Pamja e jashtme: Kokrra te plota, te shendosha, me forme dhe madhesi sipas llojit (ovale, e rrumbullaket, e gjate etj).Te jete e bardhe, pa ere myku dhe cfaredo ere tjeter te huaj. Pas zierjes te kete ere te kendshme, pa shije te hidhur ose cfaredo ere tjeter te huaj. Lageshtia jo me shume se 15% ,Lende te huaja jo me shume se 0.8%. Demtime nga insektet nuk lejohen.Te jete me thase,Thaset te jene te paster pa lende te huaja dhe te thate.

Thjerëza

Kërkohet cilesia e mirë,Thjerëzat ruhen në depo të pastra, pa lagështirë dhe të dezinfektuara. Stivat vendosen 10-15cm mbi dysheme dhe 50-60 cm larg mureve. Midis stivave lihen korridore kontrolli 50-60cm. Transporti të behet me mjete të pastra të mbrojtura nga faktoret atmosferike duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore dhe që nuk ndikojnë në karakteristikat dhe cilësinë e produktit dhe sigurojnë ruajtjen e tij higjenike.

Kokrra e të shëndosha e të plota, të pa prekura nga sëmundjet e insektet që përbëjnë objekt karantinor ose që prishin cilësinë. Nuk lejohet përzierje kultivarësh. Ngjyra e kokrrave është bezhë deri në kafe të çeltë . Pa erë myku e shije të hidhur dhe pa erë dhe shije të huaj.

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjenike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit. Thjerrëzat të ambalazhohen në qese polietileni me vëllime sipas kërkesave të AK-së.

Mbi çdo ambalazh vendoset etiketa ku shënohen:

- Emërtimi i prodhuesit,
- Emri i produktit,
- Pesha neto,
- Data e prodhimit,
- Data e skadimit,
- Kushtet e vecanta të ruajtjes.

Tërshërë

Kërkohet cilësia e mire. Të jetë kokërr tërshërë e shtypur, e pastër pa insekte dhe përzierje të huaja. Ngjyra karakteristike e tërshërës, e bardhë në të verdhë të celur. Shija dhe era karakteristike e tërshërës pa shije dhe ere myku dhe cfardo ere dhe shije tjetër të huaj. Demtues hambari të gjallë: Nuk lejohen. Lageshtia në % jo me shume se 14. Lende të huaja, insekte, papasterti nuk lejohen. Ambalazhimi i paketuar me pako me peshe 400 gr - 1 kg. Markerimi: I. Emërtimi i prodhuesit. II. Emri i produktit. III. Pesha neto ose vëllimi i produktit. IV. Data e prodhimit. V. Data e skadimit. VI. Kushtet e vecanta të ruajtjes. Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

Mashurka (bishtanja)

Treguesit cilësorë: I. Pamja e jashtme Të freskëta, të shëndosha të pastra, me fije normale për kultivarin dhe me fara që duken lehtë, me formë të drejtë, lehtësisht të deformuara. Me formë prizmi shumëkëndësh që ngushtohet në majë, të padrunjzuara e pa fije. Gjatësia në cm - Bishtaja frutshkurtër deri 6 cm - Bishtaja frutgjatë deri 8 cm Dëmtime të ndryshme (mekanike, sëmundje nga kimikatet) Lejohet deri në 5% të partisë me vyshkje të lehtë. Nuk lejohen me sëmundje e demtues. Ngjyra Tipike për kultivarin. Lejohen deri në 5% të masës me ngjyrë tjetër, me përjashtim të ngjyrës së zezë. Ndërtimi i frutit Fruta të butë me fara të vogla në fazën e qumështit. Lejohen me fruta jo të pjekura deri në 2% të masës.

Qepë e thate:

Kërkohet cilësia e mirë, të jete me pjekuri të plote, me cipe e bisht të thate, të shëndosha e të plota, me ngjyre e forme tipike të kultivarit dhe me gjatësi të bishtit deri në 7 cm. Madhësia e kokrres për ovalet të jete nga 4 deri në 5 cm. Lejohen jo me shume se 1 % e partisë me demttime të lehta dhe 1 % lende të huaja. Me sëmundje nuk lejohen. Të ngrira, të kalbura e të mykura nuk lejohen.

Presh

Kërkohet cilësia e mirë, të jete i freskët, i njomë, i pastër, me gjyre të bardhë e jeshile, i pa vyshkur dhe i lare me uje të pijshëm. Diametri në pjesën me të trasse tejete mbi 2.5-3.5 cm. Gjatësia e kercellit të jete 25-45 cm. Gjatësia e gjethit nga rozeta të jete jo me shume se 20 cm. Sistemi rrenjor të jete jo me shume se 1 cm. Demttime e sëmundje nuk lejohen.

Lule Lakër

Kërkohet cilësia e mirë dhe e freskët, të jenë formuara dhe të ngjeshura, me ngjyrë të kultivarit, jo më shumë se me 2-3 gjethë të gjelbra mbrojtëse të shkurtuara në majë dhe me gjatësi të koçanit deri 1 cm (matur nën gjethin e fundit mbajtës), të shëndosha, të pastra. Nga sëmundjet e demtues të tjerë nuk lejohen. Pesha e kokrres : Nga 0.5 kg – 1 kg .Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarve në arka të pastra të forta e të thata të prodhuara sipas standartit ose kushtit teknik të perkates në fuqi. Transporti i perimeve të freskta behet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktore të tjere atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

Spinaq

Kërkohet cilesia e mirë, i fresket , i njome, i paster me ngjyre jeshile te erret, i pa vyshkur dhe i lare me uje te paster, i lidhur ne dengje te vogla deri ne nje kg. Me rrenje te prera Gjatesia e kercellit te mos jete me shume se 5 cm Te mos kete prani te barerave te tjera. Gjethet te jene te plota me gjeresi deri ne 10 cm dhe gjatesi e gjethes deri ne 20 cm. Gjethet te jene pa njolla te ngjyres se ndryshkut, pa demtime nga krimbat, pa demtime mekanike, te fresketa dhe te pavyshkuara.

Domate

Kërkohet domate e cilësisë së mirë, ku te jene te fresketa, me forme tipike te kultivarit, te plota, te pastra, te pa vrara, te pa shtypura, pa kalbje dhe pa njolla nga diegia e diellit, te pa prekura nga semundjet dhe demtuesit si dhe te pa lagura. Pjekuria duhet te jete normale, me ngjyre te kuqe, lehtesisht roze dhe jeshile rreth bishtit. Nuk lejohen domate te tejpekura, te zbutura e te vyshkura. Demtime e semundje nuk lejohen. Madhesia e kokrres te jete :Per te hershmet 3-4 cm;Per te mesmet e te vonat 7 cm.

Kastravec

Kërkohet Kastravec i cilësisë së mirë, te jete i drejte, pa deformime, nuk lejohen kalbzime si dhe nuk duhet te kete njolla me ngjyre te verdhe.Pamja e jashtme: Të fresket me ngjyre e forme tipike të kultivarit,me perkulje të lehte. Perberja e brendshme e tulit: Me tul të forte e të lengshem.Farat e pazhvilluara e pa kore të forte. Madhesite: Gjeresia ne cm(diametri me I madh)deri5. Gjatesia ne cm nuk kerkohe. Demtime mekanike(gervishtje të lehta ne lekur)ne%jo me shume se 2.Të prekura nga insektet të kalbura nuk lejohen.

Specia

Kërkohet cilesia e mirë, te jene me forme e ngjyre te kultivarit, te fresketa, te pastra dhe me pjekuri natyrale. Lejohen demtime jo me shume se 3 % Shija te jete karakteristike e kultivarit. Lejohet shije djegese e lehte. Nuk lejohet perzierja e specave djeges me ato jo djeges. Gjatesia te jete per te gjatat mbi 10 cm dhe per te rrumbullaktat mbi 7 cm.

Marule

Kërkohet cilesia e mirë,të fresketa , të njoma, të pastërta me ngjyre jeshile te erret, jo të vyshkura dhe të lara me uje te paster, i lidhur ne dengje te vogla deri ne nje kg. Me rrenje te prera Gjatesia e kercellit te mos jete me shume se 5 cm Te mos kete prani te barerave te tjera. Gjethet te jene te plota me gjeresi deri ne 10 cm dhe gjatesi e gjethes deri ne 15 cm. Gjethet te jene pa njolla te ngjyres se ndryshkut, pa demtime nga krimbat, pa demtime mekanike, te fresketa dhe te pavyshkuara.

Karrota

Të freskëta me ngjyrë të verdhë në të kuqerremtë,formë tipike të kultivarit,me perkulje të lehtë,të jenë të pastruar me ujë të pijshëm nga balta 2.Përbërja e brendshme e tulit:Me tul të fortë,me bosht të hollë,me diameter jo më shumë se 1cm.Gjerësia deri në 4cm, Gjatësia 10- 15cm.Dëmtime mekanike (gërvishtje të lehta në lëkur) në% jo më shumë se 2.4. Të prekura nga sëmundjet,insekte të kalbura,Nuk lejohen.Ambalazhimi dhe etiketimi bazuar ne standartin 1799\88.Transporti I perimeve të freskta behet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtime te faktoreve tmosferik,duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare per transportimin e produkteve ushqimore Presh cilesia e pare.KERKESAT CILESORE-Pamja e jashtme.i fresket,I paster,I njome,me ngjyre të bardhe ne jeshile,I pavyshkur dhe

I lare me uje të pijshem.-Diametri ne pjesen me të trashe, Mbi 2.5-3.5cm.-Gjatesia e kercellit ne cm.25-45.-Gjatesia e gjethit nga rozeta,cm,jo me shume se 20cm-Sistemi rrenjor,cm,jo me shume se 1cm.-Demtime e semundje.Nuk lejohen.

Hudhra

Pamja e jashtme: Me pjekuri të plote.Me cipe e bisht të thate, të shendosha e të plota.Me ngjyre e forme tipike të kultivarit dhe me gjatesi të bishtit deri ne 4 cm. Te lidhura ne varg ose me rrjeta deri ne 250 gr. Demtime mekanike cifla, bishta, semundje,lejohen jo me shume se 1 % e partise me demtime të lehta dhe 1 % lende të huaja (cifla, bishta). Me semundje nuk lejohen. Të ngrira ,të kalbura e të mykura nuk lejohen.

Limon

Kërkesat cilësore : Pamja e jashtme: të freskët, me zhvillim normal ,të shëndoshe dhe me bisht. Ngjyra, shija dhe aroma. Ngjyre karakteristike e kultivarit e verdhe ne portokalli me ere karakteristike dhe shije të ëmbël ne të athet, pa shije të hidhur.

Brokul

Kërkohet cilësia e mirë,të jenë të freskët, të pjekur mirë, me formë të rregullt, pa dëmtime mekanike. Të kenë ngjyren karakteristike jeshile të fort të brokolit me përmasa mesatare. Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarve në arka të pastra të forta e të thata të prodhuara sipas standartit ose kushtit teknik të përkatës në fuqi. Transporti i perimeve të freskta behet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktore te tjere atmosferik duke zbatuar rregullat higjeno – sanitare per transportimin e produkteve ushqimore.

Kungull jeshil

Kërkohet cilesia e mirë. Të fresket me ngjyrë e formë tipike të kultivarit , me përkulje të lehtë përberja e brëndshme e tulit:Me tul jo shume të fortë.Farat e pa zhvilluara e me lëkurë të lëmuar.Gjerësia në cm (diametric me i madh) deri 3. Gjatësia në cm nuk kërkohet.Demtime mekanike (gervishtje të lehta në lëkurë) ne % jo me shumë se 2. Të prekura nga insektet të kalbura nuk lejohen. Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarve në arka të pastra të forta e të thata të prodhuara sipas standartit ose kushtit teknik të përkatës në fuqi. Transporti i perimeve të freskta behet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktore te tjere atmosferik duke zbatuar rregullat higjeno – sanitare per transportimin e produkteve ushqimore.

Bizele

Kërkohet cilesia e mirë,të fresketa,të njoma ,të pastra, të pathyera, me ngjyre e madhesi të kultivarit. Kokrrat në bishtaje me madhësi normale të kultivarit ,të zhvilluara mirë në fazën qumeshtore, me ngjyrë jeshile të hapur ,me lëkurë të holle ,të njomë e të embel , pa shënja drunjëzimi . Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarve në arka të pastra të forta e të thata të prodhuara sipas standartit ose kushtit teknik të përkatës në fuqi. Transporti i perimeve të freskta behet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktore te tjere atmosferik duke zbatuar rregullat higjeno – sanitare per transportimin e produkteve ushqimore.

Mish Viçi

Kërkohet mish viçi i freskët në rritje (mosha 6-12 muaj) me cilësi që të plotësojë kërkesat e standarteve. Pamja e jashtme : Sipërfaqja e jashtme të jete e mbuluar me një cipe të hollë tharje. Sipërfaqja e mishit të ftohur menjëherë pas prerjes të jete i tejdukshëm. Tendinat të jenë të ndritshme, elastike dhe të forta. Ngjyra : Mishi të jete me ngjyre roze dhe i dhjamt të jete me ngjyre të bardhë. Konsistenca : Të jete e bute dhe elastike. Në prerje të duket kompakt. Era : Të jete e këndshme, karakteristike e llojit. Palca e kockave: Të mbushi të gjithë kanalën e palces, ngjyra të jete roze në të verdhë, çdo pjesë, të jete e vulosur me vulën e inspektoriatit veterinar. Çdo parti mishi shoqërohet me certifikatën veterinarë Vula dhe të dhënat e personave përgjegjës që plotësojnë certifikatën duhet të jenë të lexueshme mirë me të cilën vërtetohet gjendja e tij e mirë shëndetësore për shitje në treg, për përpunim ose për ruajtje. Nëse nga kontrolli i kryer nuk është prekur nga sëmundje por që është i sigurt dhe se lejohet të tregtohet për konsum publik. Të sille me mjete frigoriferike i gatshëm për tu gatuar.

Kofshë pule

Kërkohet Kofshë pule i freskët. Mishi i shpendëve fitohet nga therja e përpunimi i shpendëve të gjallë sipas procesit teknologjik të përcaktuar duke zbatuar dispozitat veterinarë e sanitare në fuqi. Shpendët që kalojnë për therje të plotësojnë kërkesat cilësore të standardit në fuqi të shpendëve për therje dhe 15 ditë para therjes u ndërpritet dhënia e antibiotikëve dhe e stimulantëve të tjerë. Mishi i shpendëve të jetë i pastër, pa mbetje të zorrëve të trakesë, të kllোকës ose të pendëve. Në muskujt të mos ketë mbetje të gjakut që shkaktohen nga ç'gjakësimi jo i rregullt. Të ketë pamje të mirë me ngjyrën natyrore të llojit. Muskulatura e kofshëve të jetë e zhvilluar mirë. Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organoleptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit. Mishi i shpendëve, mbasi ka kaluar procesin e paraftohjes, pakëtohet në qeska polietileni. Marrja në dorëzim e mishit të shpendëve bëhet me parti, e cila përfaqëson sasinë që jepet njëherësh për furnizim, e të njëjtit lloj dhe me të njëjtën cilësi. Çdo parti mishi shoqërohet me certifikatën veterinarë. Mishi i pulës të jete i kontrolluar dhe i vulosur nga veterineri dhe i shoqëruar me Certifikatë Veterinarë Vula dhe të dhënat e personave përgjegjës që plotësojnë certifikatën duhet të jenë të lexueshme mirë me të cilën vërtetohet gjendja e tij e mirë shëndetësore për shitje në treg, për përpunim ose për ruajtje. Nëse nga kontrolli i kryer nuk është prekur nga sëmundje por që është i sigurt dhe se lejohet të tregtohet për konsum publik. Të sille me mjete frigoriferike i gatshëm për tu gatuar.

Vula dhe të dhënat e personave përgjegjës që plotësojnë certifikatën duhet të jenë të lexueshme mirë. Ruajtja dhe transportimi Transportimi i mishit të shpendëve, bëhet me mjete autofrigoriferë. Transporti bëhet me mjete të pastra, frigoriferike, të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore të freskëta. Transportimi i mishit të freskët (jo i ngrirë) bëhet në arka plastike ose prej materiali që nuk ndryshket.

Mish Derri

Kërkohet Mish Derri i freskët. Mishi i derrit përgatitet në gjysma. Trupi ndahet në gjysma, në mes të vertebrave të shtyllës kurrizore duke e lënë në njërin anë palcën e kurrizit. Mishi i derrit tregtohet pa dhjam, i cili hiqet me kujdes në kufirin e ndarjes së mishit nga dhjami pa dëmtuar mishin, dhe pa lënë shtresa dhjami në sipërfaqen e trupit. Mishi nuk duhet të përmbajë mbetje të organeve të brendshme, copa gjaku të mpiksur, papastërti të stomaqeve, të zorrëve dhe nuk duhet të ketë pjesë të dëmtuara nga goditjet ose abcese të brendshme. Forma e trupit të jetë e rrumbullakosur. Kurrizi dhe beli të jenë të gjerë. Kofshët dhe shpatullat të jenë të mbuluara me muskulaturë. Dhjami të mbulojë të gjithë trupin dhe trashësia e tij ndërmjet brinjëve 6 dhe 7 të jetë mbi 2.5 cm. Sipërfaqja e mishit është e mbuluar me një cipë të hollë tharje. Sipërfaqja e mishit menjëherë pas prerjes është e lagët dhe e ndritshme, lëngu del me vështirësi dhe është i tejdukshëm. Tendinat janë të shndritshme, elastike dhe të forta. Sipërfaqja e artikulacioneve është e shndritshme. Në sipërfaqe ka ngjyre me shtresë djami të kuqe, të zbehtë. Në prerje sipërfaqja duket e ndritshme jo e ngjitshme. Ngjyra e dhjavit e verdhë. - Konsistenca: E butë dhe elastike. Gjurma që formohet kur mishi shtypet me gisht, zhduket shpejt. Në prerje duket kompakt. Lëngu del me vështirësi dhe është i tejdukshëm. Era: E këndshme, karakteristike e llojit. - Palca e kockave: Mbush të gjithë kanalën e palcës së kockave. I tejdukshëm, aromatik, në sipërfaqe duken shtresa ose pika yndyre. Ambalazhimi dhe markimi Çdo trup, gjysëm trup ose çerek damkoset me vulën e kontrollit veterinar e sanitar dhe me vulën e llojit e të cilësisë së mishit. Çdo parti mishi shoqërohet me certifikatën veterinare Vula dhe të dhënat e personave përgjegjës që plotësojnë certifikatën duhet të jenë të lexueshme mirë me të cilën vërtetohet gjendja e tij e mirë shëndetësore për shitje në treg, për përpunim ose për ruajtje. Se nga kontrolli i kryer nuk është prekur nga semundje por që është i sigurt dhe se lejohet të tregtohet për konsum publik. Të silllet me mjete frigoriferike i gatshëm për tu gatuar.

Sallam popullor

Kërkohet Sallam popullor. Të jetë e cilësisë së parë. Lloji: viçi dhe derri. Në formë harku pa përdredhje. E plotë, e fortë, pa dëmtime sipërfaqësore, cipa të jetë e ngjitur mirë me brumin. Pa shenja myku ose jargë në sipërfaqe. Ngjyra e jashtme e kuqe-kafe e çelur, pa ngjyra ajri. Lejohet sipërfaqe myk i bardhë dhe i thatë, i cili s'ka depërtuar në brendësi. Fundet të jenë të lidhura mirë. Qëndrueshmëria: Elastike, nga shtypja e ushtruar të mos ngelet shenjë. Era: E këndshme, karakteristike për erërat e përdorura, pa erë të huaj. Shija: E këndshme, karakteristike për llojin e produktit me kripë normale, pa shije të huaj. Treguesit fiziko-kimik: Lagështia, %, jo më shumë se 60. Nitrit mg/100g, jo më shumë se 20. Kripë, %, jo më shumë se 3. - Yndyrë, %, jo më shumë se 28.

Ngarkesa mikrobike: - Mikroflora e përgjithshme për gram/produkt: 5000. - Ecoli, për gram produkt: Nuk lejohet. Stafilokokus aureus dhe proteus: Nuk lejohet. Salmonella, për 25 g produkt: Nuk lejohet. Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm. Analiza mikrobiologjike (bazuar urdhri 645, datë 23.12.2016) Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit. Sallamet ambalazhohet në qese plastike me vëllime sipas kërkesave të AK-së. Verifikimi i kërkesave cilësore Sallamet për shitje shoqërohen me fletë analizë ku shënohen treguesit fiziko-kimikë, organo shqisore dhe bakteriologjikë. Reklamimi i produktit nga marrësit në dorëzim për defekte të dukshme shqisore bëhet në kohën e marrjes në dorëzim. Duhet të shoqërohet me raport

analizë të rregullt sipas legjislacionit në fuqi. Raport analiza Fiziko-Kimike duhet të përmbajnë treguesit fiziko-kimikë të mësipërm. Raport analiza Mikrobiologjike duhet të përmbajë treguesit sipas legjislacionit në fuqi. Ruajtja dhe transportimi Transportimi bëhet me mjete të pastra, frigoriferike, të mbrojtura nga faktoret atmosferike, duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore, të mbuluara të destinuara për transportimin e artikujve ushqimorë.

Fileto Pule

Mish Pule Filete importi c.I-re . Treguesit cilësorë të kofshës së pulës: 1. Pamja e jashtme: Me ngjyrë rozë e celur që anon në të bardhë karakteristike e mishit të pulës cilësi e parë. 2. Ndarja anatomike: Mishi i pulës do të përbëhet vetem filete. 3. Kontrolli veterinar: Duhet të ketë vulën e kontrollit veterinar dhe të transportohet me mjete të kontrolluara. Treguesit kimik: Në përputhje me Standartin Shtetëror Shqiptar.

Kërnacka (1 pako=10 copë)

Me perberje mish lope, ose vici,i paketuar ne pako **pako=10 copë**, secila I fresket dhe i paisur me certifikaten sanitare, te mos permbaje shume yndyre dhe te sillet, me mjete frigoriferike. Mishi te jete ngjyre roze dhe te kete ere te kendeshme. Malli te jete i shoqeruar me certifikate cilesie me te gjithë parametrat.

Makarona të ndryshme

Forma: Makarona te formave të ndryshme per supe si dhe makarona te gjata dhe te shkurtra per pilaf Makarona (fusilli), **spirale, spageti** dhe Forma: **Makarona të vogla** .

Sasia dhe lloji i makaronave do të përcaktohet siaps kërkesës së AK. Pamja e jashtme: Ne forme te rregullt, te plota, me siperfaqe te lemuar deri lehtesisht te ashper . Pas zierjes makaronat te jene elastike, te mos qullozen, te mos cahen dhe te mos krijojne shkume. Ngjyra: E bardhe me nuance te verdhe, ne thyerje qelqore me jo me pak se gjysma e siperfaqes se seksionit. Era dhe shija: E mire karakteristike e makaronave pa shije te hidhur, te tharte , te mykur dhe pa cfaredo ere dhe shije tjetere te huaj. Treguesit Fiziko-kimikë Lageshtia jo me shume se 13%. Aciditeti:Acid sulfuric jo me shume se 0,16%. Rritja e vëllimit pas zierjes jo me pak se 2 here. Insekte dhe demtues te tjere nuk lejohen. Ambalazhimi dhe etiketimi Makaronat te jene te ambalazhuara me qese polietileni nga 0.5 deri 1 kg, te mos jene te miellezuara, te tregohet koha e zierjes dhe tregues te tjere: Markerimi: Emërtimi i prodhuesit. Emri i produktit . Pesha neto Data e prodhimit . Data e skadimit. 14 Kushtet e vecanta të ruajtjes. Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë,këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

Oriz

Treguesit shqisorë: 1.Pamja e jashtme: Kokrra të shëndosha, të pastëra, të zhveshura tërësisht nga lëvozhga e orizit, pa shije, pa shënja myku ose prishje. 2.Ngjyra: E bardhë, lejohen kokrra me nuancë ngjyrë të verdhë. 3.Era dhe shija: Karakteristikë e orizit të shëndoshë pa shije të thartë, të hidhur, pa erë myku dhe erë tjetër të huaj. Treguesit kimik: Në përputhje me Standartin Shtetëror Shqiptar. Ambalazhimi: Të jetë me pako prej letre 1 kg neto. Në ambalazhin të jetë shënuar edhe afati i skadencës.

Vaj për gatim

Treguesit shqisorë: 1.Pamja: Lëng vajor, i artë, pa depozitime. 2.Ngjyra: E verdhë, e lehtë. 3.Era dhe shija: E mirë, karakteristike e vajit të lulediellit të rafinuar, pa shije dhe erë të huaj. Treguesit kimik: Në përputhje me Standartin Shtetëror Shqiptar. Amballazhimi dhe etiketimi: Vaj luledielli i rafinuar do të ambalazhohet në shishe plastike me vëllim 1 litërshe, të mbyllur me tapë plastike me vidhëzim hermetike të kapsuluara me shirit PVC me stampën përkatëse. Mbi çdo shishe do të vendoset etiketa në të cilën të shënohet: - Emërtimi i plotë i mallit. - Data e skadimit ose afati i përdorimit që do të jetë 18 muaj nga data e prodhimit dhe e furnizimit në institucion.

Vaj ulliri

Treguesit shqisorë: 1.Pamja: Lëng vajor, pa depozitime. 2.Ngjyra: Në ngjyrë ulliri, e lehtë. 3.Era dhe shija: E mirë, karakteristike e ullirit, pa shije dhe erë të huaj. Treguesit kimik: Në përputhje me Standartin Shtetëror Shqiptar. Amballazhimi dhe etiketimi: Vaj i ullirit do të ambalazhohet në shishe plastike ose qelqi me vëllim 1 litërshe, të mbyllur me tapë plastike me vidhëzim hermetike të kapsuluara me shirit PVC me stampën përkatëse. Mbi çdo shishe do të vendoset etiketa në të cilën të shënohet: - Emërtimi i plotë i mallit. - Data e skadimit ose afati i përdorimit që do të jetë 18 muaj nga data e prodhimit dhe e furnizimit në institucion.

Salcë domate

Treguesit shqisorë: Pamja e jashtme: Masë pastoze, me pjesë të dukshme të përbërësve të saj, pa pjesë të djegura. Ngjyra: E kuqe deri e kuqe e thellë. Shija dhe era: Me shije dhe erë karakteristike të salcës së domates. Treguesit kimik: Në përputhje me Standartin Shtetëror Shqiptar. Amballazhimi: Salca e domates ambalazhohet në kanaçe metalike 400 gr.

Veze

VEZE PULE bazuar ne STASH I515-85 Treguesit cilësorë vezës së pulës: 1. Pamja e jashtme: E pastër dhe pa plasje.Lejohen ndotje të lehta. 2. Dhoma e ajrit: Lartësia, jo më shumë se 9 mm. 3. E bardha e vezës: E dendur e kulluar dhe e pastër pa njolla gjaku (të kontrolluar në ovoskop). 4. E verdha e vezës: Kompakte e ndodhur në pozicionin qëndror pak e lëvizshme. Lejohet devijim i vogël nga pozicioni qendror. 5. Era: Pa erë prishje dhe erë tjetër të huaj. 6. Masa: Jo më pak se 40 gr. AMBALAZHIMI: Vezët ambalazhohen në kartona fole me kapacitet 30 vezë secila dhe në çdo kuti kartoni vendosen 12 copë kartona fole. Mbi çdo ambalazh vendoset etiketa ku shënohen. Emri i ndërrmarrjes prodhuese, sasia, data e prodhimit.

Miell gruri

Treguesit shqisorë: 1.Pamja: Të jetë pluhur i njëtrajtshëm pa lëndë të huaja Insekte dhe dëmtues të tjerë nuk lejohen. 2.Ngjyra: E bardhë 3.Era dhe shija: E këndshme, karakteristike e miellit të grurit, pa erë dhe shije të huaj. Treguesit kimik: Në përputhje me Standartin Shtetëror Shqiptar. Të jetë i cilësisë së parë, i stazhionuar, i ambalazhuar në pako 1 kg letre, me etiketë prodhuesi dhe afat skadence të shënuar.

Miell misri

Treguesit shqisorë: 1.Pamja: Të jetë pluhur i njëtrajtshëm pa lëndë të huaja Insekte dhe dëmtues të tjerë nuk lejohen. 2.Ngjyra: E bardhë 3.Era dhe shija: E këndshme, karakteristike e miellit të misrit, pa erë dhe shije të huaj. Treguesit kimik: Në përputhje me Standartin Shtetëror Shqiptar. Të jetë i cilësisë së parë, i stazhionuar, i ambalazhuar në pako 1 kg letre, me etiketë prodhuesi dhe afat skadence të shënuar.

Sode buke

Te jete pluhur me ngjyre te bardhe, me eren karakteristike sodes se bukes.Te mos kete lageshtire dhe erera te huaja. Ambalazhimi: me pako ne qese cellofoni me peshe 0.1kg..Mbi ambalazh vendoset etiketaku shenohen te dhenat e meposhteme: Marketimi: Emertimi i prodhuesit. Emertimi i produktit. Pesha neto Data e skadimit Kushtet e vecanta te ruajtjes. Ambalazhimi: Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet ne menyre që të mos shkepudet nga ambalazhi. □ Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jene të qarta,të dukshme mire,të pashlyeshme dhe lehtesisht të lexueshme ne kushtet normale të blerjes dhe përdorimit. Malli të shoqërohet me certifikatë origjine dhe raportë analize të laboratorit.

Maja buke

Ngjyra dhe era karakteristike e majase se bukes ,e njetrajtshme pa njolla,pa lende te huaja.te jete ne mase brumi. Ambalazhimi . Ne pako letre me peshe 0.5 kg.Mbi ambalazh te vendoset etiketa ku shenohen te dhenat: Emertimi i prodhuesit, Emertimi i produktit, Pesha neto ose vellimi i produktit, Data e prodhimit, Data e skadimit, Kushtet e vecanta te ruajtjes.

Miell ëmbëlsire

Mielli për ëmbëlsira është përftuar nga përzierja e varieteteve më të mira të kokrrave të përzgjedhura posaçërisht për të marrë një produkt përfundimtarë të një cilësie të lartë.Përbërësi kryesorë bazë për përgatitjen e recetave si: ëmbëlsira, tarta, bigne, frolla, krostata, kek dhe torta të lehta.Mielli për ëmbëlsira, prodhohet nga një përzgjedhje e kujdeshme e grurit më të mirë të butë, është ideal për ëmbëlsira dhe ndryshon nga mielli tipit klasik për shkak të përmbajtjes së ulët të glutenit. Këto receta të përgatitura me miellin për ëmbëlsira kanë karakteristiken e të paturit shkrihtësinë e duhur.Shkrihtësia e produktit në veçanti, vjen nga përdorimi i miellrave me jo shumë të lartë, pasi tregon fortësinë, që jep një brumë me një rrjet glutinik jo të formuar plotësisht duke i dhënë një qëndrueshmëri të saktë produktit të pjekur. Miell ëmbëlsire është i lidhur me cilësinë e grurit të butë të përdorur dhe për rrjedhojë përmbajtjes së tij të glutenit. Mielli për ëmbëlsira ka një vlerë të ekuilibruar për të lejuar formimin e një rrjete glutinike të përshtatshme për të krijuar, në produktin e përfunduar, një ardhje të ekuilibruar dhe jo shumë të theksuar.

Kripë

KRIPE E JODIZUAR Treguesit cilësorë: 1. Ngjyra: E bardhë 2. Era dhe shija: E kripur pa shije dhe erë të hua. 3. Pamja e jashtme: Masë kokrrizore Treguesit fiziko kimik: 1-Imtësia në mm 0.2 – 2 . 2-Klorur Na në lëndën e thatë në %, jo më pak se 98. 3- Klorur Mg në lëndën e thatë në %, jo më shumë se 0.3. 4-Sulfat

Mg në lëndën e thatë në %, jo më shumë se 0.9. 5-Sulfat Ca në lëndën e thatë në %, jo më shumë se 0.2. 6-Lëndë të patretshme në lëndën e thatë në %, jo më shumë se 0.3. 7-Lagështirë në %, jo më shumë se 1. 8-Jodur kaliumi mg/kg 50 (+ /-)3 Kripa të plotësojë të gjithë kërkesat higjieno shëndetsore dhe normat e miratuara nga Ministria e Shëndetsisë. Markërimi: Emërtimi i prodhuesit Emri i produktit Pesha neto ose vëllimi i produktit Data e prodhimit Data e skadimit Kushtet e veçanta të ruajtjes Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë.këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë. Ambalazhimi: Të bëhet në qese të pastër ose polietileni ushqimorë, opak me masë 1 – 25 kg. Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet në mënyrë që të mos shkëputet nga ambalazhi. Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jenë të qarta, të dukshme mirë, të pashlyeshme dhe lehtësisht të lexueshme në kushtet normale të blerjes dhe përdorimit. N.q.se është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e ambalazhit duhet të jetë lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga ambalazhi. Emri i produktit ushqimor dhe përmbajtja neto duhet të bjerë në sy që në pamje të parë. N.q.se gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo është e destinuar duhet të përdoret një etikete shtesë që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe.

Uthull

UTHULL RRUSHI .Klasifikimi - Me bazë rrushi Kërkesat cilësore Treguesit shqisorë: - Pamja e jashtme: E kthjellët dhe pa turbullira. - Ngjyra: karakteristike e uthullës sipas rrushit të përdorur. - Era dhe shija: E mirë me erë dhe shije të këndshme dhe karakteristike pa shije dhe erë të huaj. Treguesit fiziko - kimik: - Masa specifike në 15°C: 1.015 - Përmbajtja e aciditetit të përgjithshëm % në vëllim shprehur në acid acetik: jo më pak se 6. - Përmbajtja e ekstraktit të përgjithshëm, gr për litër: jo më pak se 16. Ndalohet shtimi në uthull i acideve organike dhe minerale. Ndalohet përdorimi i ngjyruarve natyror dhe artificial me përjashtim të enocianines.

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit. Uthulla do të ambalazhohet në ambalazh plastik ose qelqi me vëllim sipas kërkesës së AK-së, të mbyllur me tapë plastike ose me tapë alucap. Mbi çdo ambalazh do të vendoset etiketa në të cilën të shënohet: - Emërtimi i prodhuesit, - Emri i produktit, - Pesha neto ose vëllimi i produktit, - Data e prodhimit, - Data e skadimit, - Kushtet e veçanta të ruajtjes. Kërkesat cilësore verifikohen për çdo parti. Parti konsiderohet sasia e uthullës e të njëjtit lloj, me të njëjtën mënyrë ambalazhimi dhe që dorëzohet menjëherësh. Duhet të shoqërohet me raport analizë të rregullt sipas legjislacionit në fuqi. Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm. Raport Analiza “Fiziko-Kimike” duhet të paraqitet në original, ose fotokopje të noterizuara. Ruajtja dhe transportimi Uthulla ruhet në ambiente të freskëta. Transporti të behet me mjete të pastra të mbrojtura nga faktoret atmosferike duke zbatuar rregullat higjieno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore dhe që nuk ndikojnë në karakteristikat dhe cilësinë e produktit dhe sigurojnë ruajtjen e tij higjienike. Të ruhen nga dëmtimet mekanike.

Piper të zi

Bazuar në Urdhrin e Ministrisë së Bujqësisë Nr. 645, dt. 23.12.2016, Për zëvendësimin e aneksit I, të Urdhrit nr. 234, datë 20.05.2014, Për miratimin e rregullores “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”. Klasifikimi - Lloji: Kokërr ose pluhur, cilësi e parë Kërkesat cilësore Treguesit shqisorë: - Pamja e jashtme: Të jenë të cilësisë të mirë, të thata, pa lagështi, ngjyra karakteristike e

Llojit. - Ngjyra: Ngjyrë karakteristike e llojit. Treguesit fiziko- kimik dhe shqisorë sipas SSH ISO 959-1:1998 ose ekuivalentin e tij. Analizë mikrobiologjike (bazuar në urdhrin nr. 645, datë 23.12.2016). Ambalazhimi, etiketimi, ruajtja dhe transportimi. Sipas SSH ISO 959-1:1998: “Piper, kokërr ose pluhur- Specifikimet- Pjesa 1: Piper i zi” ose ekuivalentin e tij. Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit. Erëza ambalazhohet në ambalazhim plastik ose letre me vëllime sipas kërkesave të AK-së. Mbi çdo ambalazh vendoset etiketa ku shënohen: - Emërtimi i prodhuesit, - Emri i produktit, - Peshë neto, - Data e skadimit, - Kushtet e vecanta të ruajtjes. Transporti të bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga faktorët atmosferike duke zbatuar rregullat higjieno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore dhe që nuk ndikojnë në karakteristikat dhe cilësinë e produktit dhe sigurojnë ruajtjen e tij higjienike. Verifikimi i kërkesave cilësore Duhet të shoqërohet me raport analizë të rregullt sipas legjislacionit në fuqi. Raport analiza Fiziko-Kimike duhet të përmbajë treguesit sipas legjislacionit në fuqi . Raport analiza Mikrobiologjike duhet të përmbajë treguesit sipas legjislacionit në fuqi. Raport Analiza “Fiziko-Kimike” dhe Raport Analiza “Mikrobiologjike” duhet të paraqitet në origjinal, ose fotokopje të noterizuara.

Rigon

Kerkesat cilesore Treguesit karakteristike Pamja: Te jete i thare, i pastruar nga kercelli, me arome dhe shije te kendshme karakteristike te vete bimes. Ngjyra:Te jete e gjelber e erret. Nuk lejohen te kalbura te nxira , te mykura,dhe papasterti te ndryshme. Treguesit Fiziko –Kimike Lageshtia: Jo me shume se: 14% Lende te huaja: nuk lejohen Ambalazhimi: Ne paketime te vogla , te pastra, pa lageshti, pa ere te huaj ,me peshe nga 100gr - 200gr.Ne paketim duhet te jete e bashkangjitur dhe emri tregetar,data e prodhimit ,vendi I prodhimit,menyra e ruajtjes,distributor dhe skadencia.

Majdanoz

Kerkohet cilesi e mire, i fresket , i njome, i paster me ngjyre jeshile te erret, i pa vyshkur dhe i lare me uje te paster, i lidhur ne tufa. Me rrenje te prera.Te mos kete prani te barnave te tjera. Gjethet te jene pa njolla te ngjyres se ndryshkut, pa demtime nga krimbat, te frasketa dhe te pa vyshkura.

Reçel qërshie dhe Reçel kumbulle

